



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E MONITORIMIT TË PROGRAMEVE TË TRANSPARENCËS

Nr. 422 Prot

Tiranë, më 5/3/2021

VENDIM

Nr. 09, datë 5.3.2021

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6 dhe 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës c), d) dhe e), të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me shkronjën e) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, sipas së cilës “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ka kompetencë monitorimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit”, ka kryer monitorimin on-line të transparencës proaktive të Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në pikën 1, të nenit 4 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”) parashikohet se: “Autoriteti Publik vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”.

Në nenin 6 të LDI parashikohet se: “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale miraton dhe shpërndan modele të programeve të transparencës për kategori të ndryshme të autoriteteve publike, në përputhje me legjisllacionin në fuqi...”.

Nga monitorimi i kryer në faqen zyrtare <http://akbpm.gov.al/legjisllacioni/programi-i->

transparences/, rezultoi se Autoriteti Publik, ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 1, të nenit 4 dhe nenit 6 të LDI, për të vendosur në zbatim programin institucional të transparencës sipas Urdhrit nr. 14, datë 22.01.2015, "Për miratimin e Programit Model të Transparencës"<sup>1</sup>, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në të cilin përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, por nuk ka pasqyruar në program kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t'u bërë publik në përputhje me përcaktimet e nenit 7 të LDI.

Në përfundim të procesit të monitorimit, Zyra e Komisionerit hartoi raportin përkatës. Me qëllim prezantimin e Raportit të Monitorimit të Programit të Transparencës dhe komunikimin e gjetjeve të tij për secilin autoritet publik, përfshirë dhe Autoritetin Publik/Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, si dhe me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 10 të Ligjit nr. 44/2015 i cili parashikon: "*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*", me shkresën nr. 21 Prot., datë 06.01.2021, Komisioneri vlerësoi zhvillimin e një seance dëgjimore, si hap paraprak. Seanca u zhvillua me datë 14.01.2021, në të cilën u prezantua raporti i monitorimit të Programit të Transparencës edhe për Autoritetin Publik/Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Në përfundim të seancës, Autoritetit Publik i'u la afat për dërgimin e qëndrimit në lidhje me rezultatet e monitorimit deri me datë 18.01.2021. Në tejkalim të afatit të përcaktuar, nuk rezultoi që Autoriteti Publik të ketë informuar Zyrën e Komisionerit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të sipërcituara.

Në ndjekje të procedurës së hetimit administrativ, në përputhje me nenin 31/1, shkronja "c" e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe nenit 87 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nëpërmjet shkresës nr. 213 Prot., datë 27.01.2021, Komisioneri kërkoi nga titullari i institucionit, në cilësinë e subjektit përgjegjës sipas nenit 19 të LDI, të paraqesë qëndrimin dhe provat përkatëse, brenda datës 02.02.2021.

Me shkresën nr.174/1Prot., datë 29.01.2021 Autoritetit Publik ka sqaruar se nuk ka mundur të marrë pjesë në seancën dëgjimore pasi titullari i këtij Autoriteti Publik është emëruar në fillim të vitit 2021, si dhe sqarohet se po punohet për të plotësuar rubrikat e programit me informacionin e munguar, duke kërkuar kohë deri në datën 15.02.2021 për plotësimin e programit të transparencës me informacionin përkatës.

Nga monitorimi i kryer nga Zyra e Komisionerit me datë 23.02.2021 rezultoi se programi i transparencës së këtij autoriteti vijon të jetë i pa plotësuar me kategoritë e informacionit publik të detyrueshëm për t'u publikuar sipas kërkesave të ligjit.

<sup>1</sup> Ndryshuar me Urdhrit nr. 187 datë 18.12.2020 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës, të rishikuar"

Konkretisht,

i. *Programi i Transparencës është i publikuar në përputhje me programin model të transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14, datë 22.01.2015 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Rezulton se kategoritë e informacionit të programit të transparencës, nuk janë të publikuara dhe të ndërlidhura (të linkueshme) me dokumentet përkatëse.*

ii. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.a) të LDI i cili kërkon të publikohet një përshkrim i strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik, rezulton se informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit por nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.*

iii. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.b) i cili kërkon të publikohen tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë, rezulton se informacioni gjendet i publikuar në faqen e autoritetit, citohet në tabelën e programit por nuk është i ndërlidhur me dokumentacionet përkatëse.*

iv. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.c) i cili kërkon të publikohet informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës rezulton se informacioni citohet në tabelën e programit të transparencës, por nuk është i ndërlidhur me dokumentet përkatëse.*

v. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.ç) i cili kërkon të publikohen të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit rezulton se informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në programin e transparencës.*

vi. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.d) i cili kërkon të publikohen të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të autoritetit publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime, rezulton se informacioni nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe as i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.*

vii. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.dh), i cili kërkon të publikohen të dhëna për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit, rezulton se informacioni nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.*

viii. *Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.e) i cili kërkon të publikohen të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së*

detyrimeve nga subjektet e licencuara, rezulton se *informacioni mbi të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe as nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.*

ix. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.ë) i cili kërkon të publikohen të dhëna për informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme, *nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe as nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.*

x. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.dh) i cili kërkon të publikohen të dhëna për mekanizmat monitorues, raporte audit, dokumentet me tregues performancës, informacioni mbi të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, rezulton se *informacioni nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe as nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës.*

xi. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.f) i cili kërkon të publikohen të dhëna për informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit, rezulton se *kjo kërkesë e ligjit nuk rezulton e pasqyruar në programin e transparencës. Informacioni nuk gjendet i publikuar dhe as nuk është i ndërlidhur në programin e transparencës;*

xii. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.g) i cili kërkon të publikohen të dhëna për çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik, rezulton se *informacioni nuk është i publikuar, as në faqe as në programin e transparencës;*

xiii. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.gj) i cili kërkon të publikohen të dhëna për çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik, rezulton se *informacioni nuk gjendet dhe as nuk është i ndërlidhur në programin e transparencës;*

xiv. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.h) i cili kërkon të publikohen të dhëna për një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë, rezulton se *informacioni gjendet i publikuar dhe është i ndërlidhur në programin e transparencës;*

xv. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.i) i cili kërkon të publikohen të dhëna për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të LDI, rezulton se *regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve nuk është i publikuar as në faqen e autoritetit dhe as i ndërlidhur në programin e transparencës, edhe pse është e pasqyruar si kategori në tabelën e programit.*

xvi. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.k) i cili kërkon të publikohen të dhëna për informacione dhe dokumente që kërkojnë shpesh, rezultojnë se *informacioni gjendet pjesërisht i publikuar dhe i ndërlidhur në programin e transparencës*;

xvii. Në lidhje me detyrimin sipas nenit 7.1.l) i cili kërkon të publikohen të dhëna për çdo informacion tjetër që gjykohej i dobishëm nga autoriteti publik, rezultojnë se *nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit dhe as nuk është i ndërlidhur në tabelën e programit të transparencës*.

Po ashtu, Autoriteti Publik nuk ka publikuar kontaktet e Koordinatorit të së drejtës për informim e tij në programin e transparencës, nuk ka njoftuar Zyrën e Komisionerit për caktimin e tij, si dhe nuk ka publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve në programin e transparencës.

Në pikën 3, të nenit 88 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet se: *“Organi publik merr vendimin përfundimtar vetëm pas kalimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e së drejtës për t’u dëgjuar nga pala. Mos ushtrimi i kësaj së drejte nga ana e palës në afatin e përcaktuar, nuk shkakton shtyrjen e marrjes së vendimit përfundimtar”*.

E drejta për informim është një e drejtë e sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e cila parashikon të drejtën e qytetarëve për të patur akses në dokumente zyrtare dhe detyrimin e autoriteteve publike për të përmbushur këtë të drejtë.

LDI promovon qasjen për dhënien e informacionit pa kërkesë përmes hartimit dhe miratimit të programit institucional të transparencës. Nëpërmjet Programit të Transparencës, i cili duhet publikohet në faqen zyrtare, autoritetet publike vendosin në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre, si dhe procedurat për të aksesuar e përdorur ato.

Bazuar në nenin 6 të LDI, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Programin Model të Transparencës, i cili është i detyrueshëm për zbatim nga të gjitha këto autoritete publike.

Programi Model i Transparencës, është hartuar në përputhje me nenin 7 të LDI dhe i përshtatur në kontekstin e veprimtarisë administrative të Autoriteteve Publike në përputhje dhe në zbatim të Kushtetutës, Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, si dhe Vendim nr. 145, datë 13.3.2018, për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Përgjigjeve për të Drejtën e Informimit”.

Programi Model i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës së autoriteteve publike, që çdo autoritet është i detyruar ligjërisht ta zbatojë atë.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e

informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Nga monitorimi i kryer nga ana e Zyrës së Komisionerit dhe hetimi i thelluar më pas, në përputhje me nenin 41, 87 dhe 88 të Kodit të Procedurave Administrative, rezultoi se Autoriteti Publik nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ligjor për publikimin e Programit të Transparencës në përputhje me nenet 4, 6 dhe 7 të LDI.

Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik ka patur në dispozicion gjithë kohën e nevojshme për të përmbushur detyrimin e tij ligjor, të lidhur drejtpërdrejtë me ushtrimin nga ana e qytetarëve të së drejtës së tyre kushtetuese për informim.

Pika 1 e nenit 18 të LDI, parashikon se: *“Mosrespektimi i dispozitave të këtij ligji passjell përgjegjësi administrative, sipas rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni”*.

Në pikën 2 të nenit 18 të LDI, parashikohet se: *“Veprimet dhe mosveprimet, në përputhje me këtë ligj dhe për aq sa nuk përbëjnë veprë penale, konsiderohen kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë: b) mosvënia në zbatim e programit institucional të transparencës, brenda afatit të parashikuar në pikën 1, të nenit 4, të këtij ligji, dënohet me 50 000 deri në 100 000 lekë.*

Në pikën 1 të nenit 19 të LDI, parashikohet se: *“Titullari i institucionit mban përgjegjësi ligjore-administrative për shkelje të parashikuar në shkronjën “b”, të pikës 2, të nenit 18, të këtij ligji”*.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi dhe hetimi administrativ i zhvilluar, Komisioneri vlerëson se është shkelur detyrimi për vënie në zbatim të Programit Model të Transparencës të miratuar sipas Urdhrit nr. 14, datë 22.01.2015, “Për miratimin e Programit Model të Transparencës”, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, mosveprimi i cili konsiderohet kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë në përputhje me shkronjën “b”, pika 2 e nenit 18 të LDI.

Në vendosjen e sanksionit, nga ana e Komisionerit është mbajtur në konsideratë fakti se kategori të caktuara të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 të LDI, gjenden pjesërisht të publikuara në faqen zyrtare të Autoritetit Publik.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në pikën 1 të nenit 19, shkronjën “b”, të pikës 2 të nenit 18, pikat 1 dhe 2 të nenit 21, nenin 22 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën d) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## V E N D O S A:

1. Autoriteti Publik "Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore", në zbatim të gërmave "a", "b" dhe "c", të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 6 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", të vendosë në zbatim Programin Model të Transparencës në përputhje me urdhrin nr.14, datë 22.01.2015 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës" të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ndryshuar me urdhrin nr. 187, datë 18.12.2020 "Për miratimin e Programit Model të Transparencës", të rishikuar, brenda datës 31.3.2021.
2. Dënimin e titullarit të Autoritetit Publik znj. Jetmira Bebeçi, Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë në përputhje me nenin 19, pika 1 e Ligjit nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit".
3. Masa e dënimit me gjobë, shlyhet me këste mujore. Gjoha ekzekutohet nga zyra e financës së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore brenda 6 muajve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Kundër vendimmarrjes në pikën 1, pala ka të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, sipas nenit 25 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".
5. Kundër vendimmarrjes në pikën 2, bazuar në nenin 22 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", personi ndaj të cilit është vendosur sanksioni administrativ ka të drejtë brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së njoftimit të vendimit të bëjë ankim në gjykatë sipas Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative".
6. Ky vendim u dha sot në datë 05.3.2021.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

